



Prishtinë: 03.10.2016

Kodi i ZRRE-së: V\_845\_2016

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1523\_08\_16**; dhe
- Ankesa e KESCO-së e datës **02.09.2016**.

### në seancën e mbajtur më datë 03 tetor 2016, nxori këtë:

#### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Këshilli banesor në Ulpianë Sol. P+13/1, me shifër 000940 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_1523\_08\_16** i datës 21.08.2016.

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 27.05.2016 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori B.A. për Këshillin Banesor në Ulpianë Sol. P+13/1 i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE për këto shkaqe: sipas kartelës së fundit zbritja e sipërfaqës ngrohëse nuk ka ndodhur, sepse kur zbritet ajo sipërfaqe atëherë për faturim duhet të jetë 48.37m<sup>2</sup>; procesverbalet e shqyrtuara nga organi i shkallës së parë nuk janë të vërteta sepse ato nuk ekzistojnë, në arsyetimin se vertikalet që në 2007 janë këputur, andaj edhe zbritja duhet të jetë nga 2007 e jo nga 2015; duhet të bëhet korrigjimi i faturave nga fillimi e deri më 19.12.2014. në ankesën e konsumatorit thekoshet se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së sqë të bpjnë zbrijeten e sipërfaqës ngrohëse sepse vertikalet i ka dëmtu vet Termokosi, dhe se konsumatori konsumon energjinë ngrohëse nga radiatorit e jo nga nënstacioni.

Me datë 17.11.2015 konsumatori ka parashtruar ankesë në N.Q "TERMOKOS" duke theksaur se edhe në vitet e mëhershme kanë parashtruar ankesë në TERMOKOS me ç'rast i kanë informuar se nuk kanë ngrohje në Soliterat tonë P+13/1 në Ulpianë, pra ende nuk është rregulluar ngrohja. Me datë 19.12.2014 TERMOKOS-it ka rregulluar pengesën apo prishjen në nënstacion dhe nga ajo periudhë kemi pasur ngrohje mesatare dhe prej asaj date ka filluar edhe pagesa. Konsumatori në ankesën tij ka theksuar se Këshilli shtëpiak/banesor bashkë me kryefamiljarët kanë marrë qëndrim se në rast se vazhdohet me këtë ngrohje pagesa bëhet sipas madhësisë katrore andaj edhe kemi informuar TERMOKOS-in me skicë.



Shërbimi për konsumator në N.Q. "TERMOKOS" me datë 08.01.2015 i është përgjigjur konsumatorit duke i theksuar se për sipërfaqën që nuk është bërë ngrohja është bërë zbritja.

I paknaqur me përgjigjen e Shërbimit për konsumator në N.Q. "TERMOKOS" konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke theksuar se banesat e Soliterit P+13/1 në Ulpianë kanë pasur probleme me ngrohje qendrore ndërsa faturimi është sikur të ishte ngrohja e mirë. Konsumatori ka theksuar se disa herë janë ankuar në TERMOKOS dhe atë prej vitit 2002 e tutje dhe kemi kërkuar nxemje mesatare, por që kërkesa ka mbetur e porealizuar. Përgjigja e TERMOKO-it ka qenë kryesisht se nuk ekzistojnë mundësitë teknike për një ngrohje cilësore, arsyetim tjetër ka qenë se ngrohja varet edhe nga temperaturat e jashtme, arsyetim tjetër është se nënstationi është shumë i vjetër. Konsumatori ka theksuar se arsyetimet e TERMOKOS-it janë të pavend pasi që sipas rregulloreve faturimi bëhet sipas cilësisë sipas energjisë së harxhuar, si dhe kërkesa ka qenë dhe sipërfaqja ngrohse të kontrollohet dhe të zbritet. Konsumatori ka theksuar se vertikalet e banjave 3.78m<sup>2</sup> dhe korridoret nuk kanë pasu ngrohje prej vitit 2002 gjegjësisht në vitin 2007 është ndërprerë në banjo. Konsumatori në emër të këshillit banesor kërkon nga ZRRE që t'i shqyrohet ankesa dhe të kërkohej nga TERMOKOS-i t'i lirojnë nga pagesa e faturave prej vitit 2009 e deri më 2014. Gjithashtu konsumatori ka theksuar se prej datës 19.12.2014 kujdestarja e TERMOKOS-it në Ulpianë kanë rregulluar pengesën apo prishjen në nënstation dhe pastaj kemi pasur ngrohje mesatare

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE pas analizimit të lëndës së konsumatorit ka nxjerr vendim duke e obliguar N.Q. "TERMOKOS" që të: 1) Bëjë zbritjen e sipërfaqes ngrohëse nga dhjetori 2015 dhe të korrigjoj faturat e lëshuara konsumatorëve banorë të ndërtesës në fjalë; dhe 2) Njëkohësisht udhëzohet NQ "Termokos" të eliminoj defektin në atë vertikale. Poashtu Këshilli banesor i ndërtesës të ofroj qasjen në objekte dhe poashtu duhet bërë aranzhimet që të kryej pagesën për këto punime, sepse sipas legjislacionit në fuqi përgjegjësia e ndërmarrjes mbaron në pikën e delimitimit në nënstation, ndërsa për riparimet në pjesën sekondare (instalimet në objektin e konsumatorit) duhet bërë pagesa

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 03.10.2016 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga ana e konsumatorit Këshilli banesor në Ulpianë Sol. P+13/1 të parashtruar nga D.K. dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të pikës së kundërshtimit të konsumatorit se sipas kartelës së vitit 2016 nuk është bërë zbritja e sipërfaqes ngrohëse, konstaton se organi i shkallës së parë DMK me të drejtë ka vërtetuar faktin se zbritja e sipërfaqes ngrohëse për faturim duhet të bëhet nga dhjetori 2015 dhe atë bazuar në përgjigjen e N.Q. "TERMOKOS".

Bordi i ZRRE-së pasi analizoj pikën e kundërshtimit të theksuar në ankesë lidhur me kundërshtimin e procesverbaleve të përpiluara nga punëtorët e autorizuar të N.Q. "TERMOKOS" se ato nuk janë të vërteta dhe nuk ekzistojnë, konstaton se procesverbalet N.Q. "TERMOKOS" janë dërguar në ZRRE në formë zyrtare dhe se ato janë shqyrtuar për të nxjerrë një vendim të drejtë dhe të bazuar në fakte, dhe se secili institucion mban përgjegjësi ligjore për dërgimin e dokumenteve të sakta apo jo të sakta.

Gjithashtu Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe pikën tjetër të kundërshtimit të theksuar në ankesë ku është kërkuar korrigjimi i faturave të ngrohjes qendrore nga fillimi e deri më 19.12.2014, dhe konstaton se sipas procesverbaleve zyrtare të N.Q. "TERMOKOS" është konstatuar se konsumatorët e asaj ndërtese kanë pasur ngrohje të mirë edhe viteve të mëherëshme dhe se për këtë nuk mund të bëhet korrigjimi i faturave të ngrohjes për periudhën e cekur nga konsumatori. Gjithashtu Bordi i



ZRRE thekson se sipas transaksioneve të konsumatorit vërehet se N.Q. "TERMOKOS" ka bërë zbritje të faturave të ngrohjes për shkak të cilësisë së ngrohjes edhe periudhat e mëherëshme dhe kjo vëretetohet edhe nga kartela financiare e konsumatorit.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në rregulla dhe ligje.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 15.07.2016 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Krenar Bujupi, u.d kryesues

---

Arsim Janova, anëtar

---

Qemajl Mustafa, anëtar

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit Këshilli banesor në Ulpianë Sol. P+13/1 të parashtruar nga D. K.),
- N.Q. "TERMOKOS" dhe
- Arkivit të ZRRE-së.